



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	17-01-2024	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/KM	310/2024		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1428/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajrajtari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1428/2023 të datës 21.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.01.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1428/2023 e datës 21.11.2023, e parashtruar nga ankuesja

II. Obligohet Zëvendësuesi i Drejtorit i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit, ankueses t'ia bëjë kompensimin e një (1) page jubilarë me rastin e njëzet (20) vite përvojë pune të pandërprerë në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile e punësuar në pozitën e punës "*Zyrtare për Financa*" në Qendrën e Paraburgimit në Pejë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 21.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër protokoll 287 të datës 20.11.2023 të Udhëheqësit të

Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankueses për realizimin e të drejtës së një (1) page jubilarë, me pretendimin ankimor se gjendja faktike e vërteton se të njëjtës i takon realizimi i të drejtës së një page jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 27.11.2023 ka përcjell shkresat lidhur me këtë çështje ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7044/2023 të datës 21.11.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për pagë jubilarë të datës 04.10.2023 të ankueses drejtuar Menaxherit të Burimeve Njerëzore të SHKK; Përgjigje në ankese me numër protokollit e datës 17.11.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të SHKK-së; Njoftimin e datës 22.12.2020 të dërguar me e-mali nga R.H për D.L, A.B, L.K, S.M, B.D, L.G, G.K, F.H, F.M, H.M, A.A, H.H, A.M, A.R, E.B, A.H, E.B dhe A.B; Akt emërim i lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për ankuesen me datë 22.07.2019; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Formulari i regjistrimit të ankesës i datës 21.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.11.2023; Përgjigje në ankesë e datës 27.11.2023; Shkresë e datës 27.11.2023 me shifër:1413; Vërtetimin e përvojës së punës e datës 27.11.2023 lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja është e punësuar në shërbimin korrektues të Kosovës, dhe e i njëjta sipas Aktit të Emërimit të datës 05.03.2013 ushtron pozitën e punës "Zyrtare Financiare", në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, në kuadër të Shërbimit korrektues të Kosovës, ndërsa sipas vërtetimit mbi përvojën e punës të lëshuar me datë 27.11.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të SHKK-së, dëshmohet fakti se ankuesja marrëdhënien e punës në të njëjtin institucion për herë të parë e ka themeluar me datë 05.12.2002 dhe vazhdon të punojë në pozitën e punës sipas akt emërimit të lartcekur, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja më datë 04.10.2023, kishte parashtruar kërkesë të organi i punësimit mbi bazën e kompensimit të pagës Jubilarë në vlerën e një pagë, me rastin e mbushjes së dhjetë (10) vjet përvoja pune të pandërprera. Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës në përgjigje të datës 17.11.2023 ka njoftuar ankuesen se, **citat:** *"duke pasur parasysh që realizimi i të drejtës në page jubilarë ndërlidhet me përvojën e punës të bazuar në listat e pagave që në rastin tuaj nuk ka mundur të realizohet deri sa ka qenë në fuqi paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i nenit 29 të Ligjit Nr.08/131 për Shërbimin Korrektues pasi që në listat e pagave keni 19 vite përvojë pune edhe pse ju keni themeluar punën me datën 01.12.2002 dhe gjendja faktike e përvojës tuaj në punë është mbi 20 vite.*

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozita e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 dhe 2 të ku përcaktohet se: *"1.Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës", "2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës" , si dhe nenin 87 ku përcaktohet se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës", konstaton se pretendimet ankimore të ankueses e cila kërkon që t'i bëhet kompensimi me rastin e arritjes se njëzet (20) vite eksperiencë në këtë institucion respektivisht e njëjta kërkon realizimin e pagës jubilarë, i bazon në dispozitat e nenit 29 pika 1.2.1 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.*

Kolegji i Këshillit, në bazë të gjendjes së plotë faktike dhe rrethanave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses lidhur me realizimin e të drejtës së pagës jubilarë, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se ankueses në bazë të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës respektivisht Neni 29, Paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 dhe nën paragrafin 1.2.1 ku theksohet se: *1. "Përveç të Drejtave që janë të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit të Punës, personeli i SHKK-së ka edhe këto të drejta dhe detyrime specifike, 1.2. e drejta e pagës jubilarë: 1.2.1. personeli i SHKK-së gëzon të drejtën e një page jubilarë për çdo dhjetë (10) vite përvojë pune të pandërprerë në vlerë të një page bazë ", andaj duke u bazuar në vërtetimin e datës 27.11.2023 të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës ankueses i takon e drejta e realizimit për pagën jubilarë sepse e njëjta ka përmbushur vitet e përvojës punës gjithsejtë 20 (njëzet) vite me datë 04.12.2022, pra disa muaj para barazimit të viteve të përvojës së punës në Listën e Pagave të realizuar nga Ministria e Financave, si dhe para datës 05.02.2023 të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili ligj shfuqizon nenet e lartë cekura të Ligjit NR. 08/L-131 Për Shërbimin Korrektues të Kosovës.*

Kolegji i Këshillit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstatimin për realizimin e të drejtës në pagë jubilarë të ankueses e mbështet edhe në analizimin e Ligjit të Pagave Nr. 03/L-147, neni 22, paragrafi 2 dhe nën paragrafi 2.3 i cili thekson se: *"Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: 2.3. shpërblimi i përvojës (jubile)", pasi faktikisht e njëjta me datë 04.12.2022 ka përmbushur 20 (njëzet) vite të përvojës së punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe rrjedhimisht para datës të 05.02.2023 të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 të Pagave për Pagat në Sektorin Publik si dhe Ligjit nr.08/l-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës*

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1428/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

